

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5616
E mërkurë, 31 tetor 2018
çmimi 0.40 €

Pacientët nuk po i marrin shërbimet shëndetësore me kohë

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI I KOSOVËS SOT (E MËRKURË) DO TË DISKUTOJË
PËR DIALOGUN KOSOVË - SERBI

FAQE 4-5

Palmeri ndikon që subjektet politike të reflektojnë për dialogun

Vizita në Kosovë e ndihmës-sekretarit amerikan të Shtetit, Matthew Palmer, ka bërë që të reflektojnë subjektet politike karshi dialogut Kosovë - Serbi. Këtë e ka konfirmuar të martën edhe kryeministri Ramush Haradinaj derisa ka treguar se pozita do të jetë pjesë e seancës së jashtëzakonshme parlamentare të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), ku do të diskutohet për dialogun Kosovë - Serbi. LDK-ja është shprehur e bindur për miratimin e rezolutës së saj nëpërmjet së cilës synon ta ndalë përpjekjen e presidentit Thaçi që në fazën finale të dialogut të bisedohet për korrëhimin e kufirit Kosovë - Serbi



AKTUALE

**NË BAZË TË
CILAVE VLERA
MBAHEN TË
IZOLUAR MË PAK
SE DY MILIONË
SHQIPTARËT E
EVROPËS?** F. 12



Nga Jakup
KRASNIQI

**ÇFARË
TREGOJNË
VEPRIMET
LUFTËNXTËSË
TË SERBISË?** F. 12



Ramadan QEHAJA

**NGA VITI 2019 NDALOHET
QARKULLIMI I VETURAVE QË
NDOTIN AMBIENTIN** F. 7



Qeveria miraton plotësim-ndryshimin e ligjit për financimin e subjekteve politike

Kabineti qeveritar ka aprovuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për financimin e subjekteve politike. Në kuadër të këtyre plotësimeve dhe ndryshimeve në ligj parashihet qartësimi i dispozitave, me theks të veçantë kontrolli i financimit të subjekteve politike, auditimi i raporteve financiare dhe publikimi i tyre, si dhe përcaktimi i dispozitave ndëshkuese për subjektet politike që nuk i zbatojnë kërkesat ligjore

FAQE 3



**Ministrja Hoxha
merr përkrahjen
e Hungarisë
për liberalizimin
e vizave** F. 2

EKONOMI

**FMN-ja SHPALOSI
SHQETËSIMET PËR
PROJEKTBUXHETIN E 2019-s** F. 9

**BIE NUMRI I NDËRMARRJEVE
TË REGJISTRUARA
NË KOSOVË** F. 9

SPORT



**BREGU: DITË TË MIRA E
PRESIN GJIMNASTIKËN E
KOSOVËS** F. 16

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Vasa, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Thaçi: Kosova u nderua në Turqi, Beogradi le të krrokatë sa të dojë

PRISHTINË, 30 TETOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se gjatë inaugurimit të aeroportit të ri në Stamboll, shteti i Kosovës është prezantuar njësoj si shtetet e tjera, me simbolet që

ka. Këto komente vijnë pasi presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, kishte deklaruar se gjatë inaugurimit të aeroportit më të ri në Stamboll të Turqisë kishte kërkuar nga organizatorët që

të hiqet flamuri i Kosovës. "Kam kërkuar të hiqet flamuri i Kosovës dhe ashtu është vepruar", ka thënë Vuçiqi. Por, Thaçi në një postim në llogarinë e vet në "Facebook" ka thënë se Serbia mund të

krrokatë sa të dojë. "Në Stamboll të Turqisë është nderuar shteti i Kosovës dhe shteti i Shqipërisë. Krenar me respektin që u bëhet shteteve tona. Beogradi le të krrokatë sa të dojë", ka shkruar Thaçi.



Ministrja Hoxha merr përkrahjen e Hungarisë për liberalizimin e vizave

Ministri i Brendshëm i Hungarisë, Sandor Pinter, në takim me ministren Dhurata Hoxha, ka ritheksuar se liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës do të sillte vetëm të mira jo vetëm për Kosovën dhe rajonin, por edhe më gjerë, duke rikonfirmuar mbështetjen e gjithanshme nga Hungaria



PRISHTINË, 30 TETOR - Ministrja për Integrim Evropian, Dhurata Hoxha, u prit në takim në Budapest nga ministri i Punëve të Brendshme të Hungarisë, Sandor Pinter. Gjatë këtij takimi ajo ka theksuar rëndësinë e liberalizimit të vizave dhe plotësimin e kriterëve nga ana e Kosovës për liberalizim.

Ministrja Hoxha e ka njoftuar nga afër me të arriturat dhe sfidat e procesit integruar, Pinterin, në veçanti rreth plotësimin të

kriterëve për liberalizimin e vizave, njëherësh ka kërkuar mbështetje nga ai për këtë proces në mbledhjen e Këshillit të ministrave. Hoxha ka thënë se lëvizja e lirë do të shënonte një moment tepër të rëndësishëm për qytetarët tanë.

Ministrja Hoxha, duke vënë në pah uljen e jashtëzakonshme të migrimit ilegal në vitet e fundit, fushatën e suksesshme të informimit rreth rregullave për lëvizjen e lirë në shtetet e

Shëngënit, si dhe anketave kredibile rreth përqindjes së ulët të të rinjve për migrim, janë faktorë që do të ndikonin në vendimmarrje, nga ministrat përkatës në Këshillin e Ministrave.

Ministri Pinter e ka falënderuar ministren Hoxha për argumentet e parashtruara, duke vënë në

spikamë rëndësinë e përbushjes së kriterëve nga udhërrëfyesi, por edhe të faktit se Kosova është i vetmi vend në Evropë me kufizim të lëvizjes së lirë. Ai e ka siguruar ministren Hoxha se Hungaria që nga fillimi i demokracisë ishte krah qytetarëve të Kosovës jo vetëm me njohjen e pavarësisë,

por edhe për integrim në organizatat ndërkombëtare. Pinteri ka ritheksuar se liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës do të sillte vetëm të mira jo vetëm për Kosovën dhe rajonin, por edhe më gjerë, duke rikonfirmuar mbështetjen e gjithanshme nga Hungaria.

Vizita e Netanyahu në Tiranë, shpresë për njohjen e Kosovës nga Izraeli

TIRANË, 30 TETOR - "Vizita në Tiranë e kryeministrit të Izraelit, Benjamin Netanyahu, do t'i shërbejë forcimit të mëtejshëm të marrëdhënieve miqësore dhe të bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Izraelit, në emër të interesit reciprok si dhe të paqes e të stabilitetit në botë", deklaroi Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë, i cili shpreh kënaqësinë e veçantë për këtë vizitë. "Populli shqiptar i ka dëshmuar në kohë shumë të vështira ndjenjat e tij miqësore ndaj popullit hebre, duke e renditur veten ndër shembujt e rrallë të atyre që morën në sy rrezikun nazist për t'i mbrojtur

hebrejtë e përndjekur. Shqipëria ka qenë ndër vendet e para që ka njohur shtetin e Izraelit dhe ka mbrojtur vazhdimisht ekzistencën e tij si shtet i pavarur", thekson Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë.

Ky Këshill shpreh në këtë rast shpresën se kjo vizitë do të ketë si rezultat të rëndësishëm edhe zhbllokimin e njohjes së Republikës së Kosovës si shtet i pavarur e sovran nga ana e shtetit të Izraelit. "Pavarësia e Kosovës është pjesë e natyrshme e procesit historik të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe është kryer jo vetëm në përputhje me



vullnetin e popullit të Kosovës, por edhe në përputhje të plotë me të drejtën ndërkombëtare siç është provuar edhe nga vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të

Drejtësisë. Njohja e pavarësisë së Kosovës nga shteti i Izraelit do t'i shërbejë fuqishëm forcimit të ndjenjave miqësore të të gjithë shqiptarëve ndaj popullit hebre", deklaroi Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë.

Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë inkurajon drejtuesit e lartë të shtetit e të Qeverisë shqiptare që çështjen e njohjes së pavarësisë dhe të sovranitetit të Kosovës ta shtrojnë përpara mikut të nderuar me seriozitet, vendosmëri dhe argumente, gjithnjë në frymën e mirëkuptimit, si një çështje e mbetur pezull. "Njohja zyrtare e

Kosovës do të vlerësohej jo vetëm si një hap miqësor nga ana e shtetit të Izraelit ndaj shqiptarëve në mbarë botën, por edhe si një vendim që i shërben paqes dhe stabilitetit në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ne presim që Izraeli ta ndjekë shembullin e aleatëve të vet të mëdhenj, ShBA-së, Mbretërisë së Bashkuar dhe Francës, anëtarë të përhershëm të Këshillit të Sigurimit në OKB, të cilët e kanë njohur Republikën e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran dhe zhvillojnë tashmë me të marrëdhënie të ngushta politike, diplomatike, ekonomike dhe kulturore", thotë Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë.

Meta takon homologun pakistanez në Stamboll

TIRANË, 30 TETOR - Gjatë vizitës së tij në Stamboll, presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, pati një takim të veçantë me presidentin e Pakistanit, Arif-Ur-Rehman Alvi. Gjatë takimit u bisedua për forcimin e mar-

rëdhënieve dy dhe shumë-palëshe dhe ato ekonomike. Presidenti Meta i uroi presidentit Alvi suksese në detyrën e re si president i Pakistanit dhe e siguroi atë për vazhdimin e forcimit të

bashkëpunimit tradicional midis dy vendeve tona, veçanërisht atyre në fushën ekonomike dhe shkëmbimeve tregtare.

Presidenti Meta inkurajoi presidentin Alvi për angazhimin

e tij kundër ekstremizmit dhe terrorizmit, për t'i dhënë Pakistanit një rol të rëndësishëm për paqen në rajon. Të dy presidentët u pajtuan për të shkëmbyer vizita në nivelin më të lartë.



Është mbajtur mbledhja e radhës e Qeverisë së Kosovës

Qeveria miraton plotësim-ndryshimin e ligjit për financimin e subjekteve politike

Kabineti qeveritar ka aprovuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për financimin e subjekteve politike. Në kuadër të këtyre plotësimeve dhe ndryshimeve në ligj parashihet qartësimi i dispozitave, me theks të veçantë në kontrollin e financimit të subjekteve politike, auditimi i raporteve financiare dhe publikimi i tyre, si dhe përcaktimi i dispozitave ndëshkuese për subjektet politike që nuk i zbatojnë kërkesat ligjore



**EPOKA
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 30 TETOR - Qeveria e Kosovës në mbledhjen e së martës ka miratuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për financimin e subjekteve politike. Në kuadër të këtyre plotësimeve dhe ndryshimeve në këtë ligj parashihet qartësimi i dispozitave, me theks të veçantë në kontrollin e financimit të subjekteve politike, auditimi i raporteve financiare dhe publikimi i tyre, si dhe përcaktimi i dispozitave ndëshkuese për subjektet politike që nuk i zbatojnë kërkesat ligjore. Kabineti qeveritar ka aprovuar edhe vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Në program do të përfshihet Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes për kredi midis Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për projektin e sistemit të largimit të ujërave të zeza për Komunën e Podujevës dhe Projektligji për ratifikimin e protokollit shtesë të marrëveshjes për ndryshimin dhe aderimin në marrëveshjen e tregtisë së lirë të Evropës Qendrore. Kurse në Programin legjislativ të vitit 2019 do të barten Projektligji për partneritet publiko-privat; Projektligji për Agjencinë e Tatimeve dhe Doganës; Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes për hua ndërmjet KfW Frankfurt am Main dhe Republikës së Kosovës

për përmirësimin e rrjetit të transmissioinit, faza e gjashtë; si dhe Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes për hua ndërmjet KfW Frankfurt am Main dhe Republikës së Kosovës për përmirësimin e rrjetit të transmissioinit, faza e shtatë.

Qeveria ka miratuar edhe dy vendime preliminare të shpronësimit të pronave të paluajtshme që preken nga ndërtimi i Memorialit "Baza e parë e UÇK-së" dhe "Kulla e Zahir Pajazitit"; si dhe objektit të ish-Gjykatës Themelore në Prishtinë për nevoja të akomodimit të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës. Po ashtu, kabineti qeveritar ka përkrahur krijimin e një grupi punues për përgatitjen e një dokumenti propozues për zgjidhjen e çështjes së akomodimit të institucioneve publike të Republikës së Kosovës të propozuar nga ministri i Administratës Publike, Mahir Jaghillar.

Në mbledhjen e së martës Qeveria ka miratuar edhe nismën në parim për marrëveshjen për heqjen e vizave në mes të Republikës së Kosovës dhe Antigua dhe Barbuda.

Mbështetjen e Qeverisë e ka marrë edhe Rregullorja për të drejtën e kompensimit të veçantë dhe reprografik. Kjo rregullore përcakton tarifën e kompensimit të veçantë, e cila duhet të paguhet me rastin e shitjes së parë apo importimit të bartësve të medimeve të zbrazëta audiovizuale dhe tarifën e kompensimit të veçantë për shitjen

apo importimin e parë të aparatëve të reja për fotokopje dhe skanim.

Kabineti qeveritar ka miratuar edhe Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndërmjetësimin e kontesteve në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Rregullorja trajton çështjen e fillimit të procedurës së ndërmjetësimit në konteste të përcaktimit të tarifave të përgjithshme për shfrytëzimin e materialit të mbrojtur me të drejtën e autorit dhe çështjen e propozimit të ndërmjetësuesit në këto konteste. Rregullorja përcakton edhe kohëzgjatjen e procedurës së ndërmjetësimit të kontesteve në lidhje me përcaktimin e tarifave të përgjithshme.

Po në këtë mbledhje Qeveria ka miratuar edhe vendimet përfundimtare të shpronësimit për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i projektit të zgjerimit të rrugës nacionale, hyrja në qytetin e Prizrenit, zona kadastrale Dushanovë, Atmaxhë dhe Landovicë në Komunën e

Prizrenit; pronat të cilat preken nga realizimi i projektit për rehabilitimin e rrugës Klokot - Gjilan dhe pronat të cilat preken nga ndërtimi i autostradës Prishtinë - Hani i Elezit.

Me propozimin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është miratuar edhe vendimi për themelimin e Këshillit për pronësi intelektuale, si organ këshillëdhënës në fushën e të drejtave të pronës intelektuale, i cili do të funksionojë në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Veprimtaria dhe organizimi i Këshillit do të përcaktohet me statusin që do të aprovohet nga Këshilli Shtetëror për Pronësi Intelektuale.

Miratimin nga Qeveria e ka marrë edhe inicimi për fillimin e negociatave të Marrëveshjes për "Mbrojtje dhe promovim të investimeve" në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë. Ndërsa në parim është miratuar edhe nisma për marrëveshje në fushën e arsimit për njohje reciproke të kualifikimeve në: Doktor i mjekësisë, dentist, arkitekt dhe inxhinier i ndërtimtarisë mes gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Qeveria e Kosovës në këtë

mbledhje ka miratuar edhe koncept-dokumentin për tubimet publike.

Dokumenti kontribuon në forcimin e prioritetit strategjik për qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit në vendin tonë dhe ka për objektive ruajtjen e sigurisë dhe përmirësimin e shërbimeve për qytetarët.

Kabineti qeveritar ka aprovuar kërkesën e Komunës së Deçanit për ndarjen e mjeteve financiare për nevojën e kompensimit të pronave private dhe objekteve që preken nga realizimi i projektit rregullues në qendër të qytetit të Deçanit. Gjithashtu, kabineti qeveritar është informuar nga ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, për ecurinë e realizimit të projekteve të Instrumentit të Paraanëtarësimit (IPA).

Edhe ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka njoftuar kabinetin qeveritar me gjendjen aktuale të punësimit të personave me aftësi të kufizuara. Ai ka kërkuar nga Ministria e Administratës Publike që të krijojë mekanizma për zgjidhje afirmative për punësimin e kësaj kategorie të marginalizuar sociale.

Tahiri e Smithi diskutuan për Dhomat e Specializuara



PRISHTINË, 30 TETOR (ER) - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka pritur të martën në takim prokurorin e specializuar nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, Jack Smith. Ministri Tahiri ka shprehur gatishmërinë e institucioneve të Republikës së Kosovës për t'i përmbushur të gjitha obligimet ndaj Dhomave të Specializuara,

të cilat janë themeluar me ndryshimet kushtetuese dhe ligjore të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Gjatë takimit, ministri Tahiri kërkoi nga prokurori Smith që qytetarët që potencialisht mund të jenë subjekt i paraqitjes pranë këtyre Dhomave, të trajtohen në përputhje me normat dhe standardet më të larta të të drejtave

të njeriut dhe të bazuara në standardet më të avancuara juridike ndërkombëtare.

Pas takimit të veçantë mes ministrit Tahiri dhe prokurorit Smith është mbajtur edhe një takim i përbashkët me kryesuesin e Këshillit Gjyqësor, Nehat Idrizi, si dhe kryesuesin e Këshillit Prokurorial, Blerim Isufaj.



Kuvendi i Kosovës sot (e mërkurë) do të diskutojë për dialogun Kosovë - Serbi

Palmeri ndikon që subjektet politike të reflektojnë për dialogun

Vizita në Kosovë e ndihmëssekretarit amerikan të Shtetit, Matthew Palmer, ka bërë që të reflektojnë subjektet politike karshi dialogut Kosovës - Serbi. Këtë e ka konfirmuar të martën edhe kryeministri Ramush Haradinaj derisa ka treguar se pozita do të jetë pjesë e seancës së jashtëzakonshme parlamentare të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), ku do të diskutohet për dialogun Kosovë - Serbi. LDK-ja është shprehur e bindur për miratimin e rezolutës së saj përmes së cilës synon ta ndalë përpjekjen e presidentit Thaçi që në fazën finale të dialogut të bisedohet për korrigjimin e kufirit Kosovë - Serbi

EPOKA ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 30 TETOR - Subjektet politike opozitare do të marrin pjesë në seancën e jashtëzakonshme parlamentare e cila do të mbahet sot (e mërkurë), në të cilën synohet të miratohet rezoluta e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për bisedimet me Serbinë.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka shprehur optimizëm të martën se në këtë seancë grupet parlamentare në pushtet dhe opozitë do të gjejnë gjuhë të përbashkët për çështjen e dialogut. "Unë besoj se të mërkurën do ta gjejnë një gjuhë të përbashkët. Nuk besoj se ka një subjekt politik në parlament

që është kundër ruajtjes së territorit, të kufijve, të kushtetutshmërisë së vendit tonë. Besoj dhe shpresoj se do ta gjejnë një gjuhë të përbashkët. Është inkurajues fakti se në këtë seancë të thirrur nga opozita do të marrë pjesë edhe pozita dhe mendoj se ky është një lajm i mirë", ka thënë Haradinaj në një konferencë me gazetarë pas mbledhjes së Qeverisë.

Ai ka bërë me dije se subjektet politike në vend duket se kanë reflektuar pas vizitës në Kosovë të ndihmëssekretarit amerikan të Shtetit për Çështje Evropiane, Matthew Palmer. "Vizita e fundit e z. Palmer dhe shumë takime që kanë ndodhur, kanë bërë që të ketë një reflektim pozitiv të spektrit politik. Mendoj se është

mirë ta kurorëzojmë atë vizitë, atë kujdes të Amerikës për proceset e rëndësishme në vendin tonë, me një pozicion të qartë strategjik që të mbrohen kushtetutshmëria, territori dhe kufijtë. S'ka rëndësi se kush më shumë ka kontribuar në atë rezolutë, e rëndësishme është të ruhen interesat kombëtare dhe unë besoj se edhe Aleanca, edhe Nisma, PDK-ja dhe partitë politike nuk e kanë problem ta mbrojnë territorin", ka thënë Haradinaj.

Edhe shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka treguar se kjo parti do të marrë pjesë në këtë seancë. Ai ka thënë se nuk do ta votojë rezolutën e propozuar nga LDK-ja. Sipas tij, duhet të tejkalohet pika e rezolutës kur kërkohet të kufizohet presidenti në këtë proces, duke shtuar se kjo rezolutë duhet të përfshijë edhe pika të tjera siç është ndalimi i krijimit të një autoriteti të tretë në Kosovë si dhe kërkesën për njohjen reciproke.

Kurse LDK-ja pret që në këtë seancë të miratohet kjo rezolutë. Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, ka ftuar të gjitha subjektet politike që të

jenë pjesë e kësaj seance. "Ne presim që nesër në seancën e jashtëzakonshme të miratohet rezoluta 'se askush nuk mund të negociojë për territorin e Kosovës'. Kjo është vija e kuqe më e rëndësishme në procesin e dialogut me Serbinë. Në deklarimet publike të gjitha grupet parlamentare janë shprehur kundër që territori i Kosovës të jetë pjesë e dialogut. Ftojme të gjitha grupet parlamentare të jenë në seancë dhe ta mbështesin këtë rezolutë", ka shkruar Hoti në profilin e vet në "Facebook". Sipas tij, me këtë rezolutë do të ndalet përpjekja e presidentit që në fazën finale të dialogut të bisedohet për korrigjimin e kufirit Kosovë - Serbi. "Ne dëshirojmë që përmes kësaj rezolute të dërgojmë mesazh te partnerët tanë ndërkombëtarë, se qytetarët e Kosovës nuk kanë vullnet të negociojnë për territorin e Kosovës.

Ne dëshirojmë ta ndalim përfundimisht presidentin që të luajë çdo ditë me ndjenjat e qytetarëve të Kosovës për shtet të pavarur, sovran dhe të pacenueshëm në tërësinë territoriale të tij", ka shkruar Hoti.

Sot (e mërkurë) pritet të mbahet seanca e jashtëzakonshme e

thirrur nga 42 deputetë nënshkrues, ku LDK-ja përmes një rezolute do të kërkojë që presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të mos flasë për korrigjim kufijsh në dialogun Kosovë - Serbi.

Zëvendësndihmës sekretari amerikan i Shtetit, Matthew Palmer, gjatë vizitës në Kosovë ka siguruar liderët shtetërorë se ShBA-ja e mbështet procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Kryeparlamentari Kadri Veseli ka deklaruar se status quoja lidhur me dialogun është duke e dëmtuar Kosovën dhe se kjo gjendje është e papranueshme për Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian. Në një video të postuar në profilin e vet në "Facebook", Veseli ka thënë se mungesa e unitetit po e rrezikon Kosovën në këtë proces. "Kemi ardhur në një moment kur dallimet tona të brendshme rrezikojnë seriozisht vendin tonë në këtë proces, duke e fuqizuar Serbinë në arenën ndërkombëtare dhe duke e dobësuar Kosovën. Këtë ne nuk duhet ta lejojmë", është shprehur Veseli. Ai ka tërhequr vërejtjen se ShBA-ja dhe BE-ja nuk do të presin pafundësisht për shkak të dallimeve dhe kalkulimeve të brendshme politike.

Veseli: Po e transformojmë shëndetësinë

PRISHTINË, 30 TETOR - "Tash e një vit jemi duke bërë përpjekje të mëdha për ta transformuar shëndetësinë, e cila prej vitesh ka qenë e lënë pas dore. Në fund të këtij mandati synojmë të kemi një sistem shëndetësor të standardeve bashkëkohore", kështu ka thënë kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, në tryezën për kancerin e gjirit, organizuar të martën në Prishtinë nga rinia e Partisë Demokratike e Kosovës.

Në fjalën e tij para të pranishmëve, kryetari i PDK-së ka thënë se sot në botën bashkëkohore jeta kualitative e qytetarëve, siguria, shëndeti, stabiliteti ekonomik janë prioritete që i japin kuptim politikës, jo frazat

bombastike e patriotizmat abstrakte. "Ne sot jemi bërë bashkë në këtë tryezë për të trajtuar një problem shumë të ndjeshëm dhe shumë sfidues për mirëqenien e qytetarëve tanë, familjeve tona, fëmijëve tanë. Ky është problem i kancerit të gjirit. Statistikat janë shqetësuese. Ato flasin se nga viti në vit rastet e kancerit të gjirit kanë ardhur duke u shtuar në Kosovë. Kjo sëmundje ka një ndikim të drejtpërdrejtë negativ si në jetën e grave të prekura prej saj, njëkohësisht në familjet tona, në mirëqenien e fëmijëve", ka theksuar Veseli. Ai ka shtuar se reagi mi duhet të jetë i përbashkët si shoqëri dhe si shtet, që me poli-

tika të duhura të ndikojë në ndalimin e këtij trendi shqetësues të rritjes së rasteve me kancer të gjirit.

Krahas kësaj, Veseli ka thënë se ka edhe mundësi për t'u gjetur pranë nënave, motrave e grave që tanimë janë të prekura prej tij. "Tash e një vit jemi duke bërë përpjekje të mëdha për ta transformuar shëndetësinë e Kosovës, e cila prej vitesh ka qenë e lënë pas dore. Ky transformim ka dy qëllime: qëllimi i parë, pacientët kosovarë duhet të gjejnë shërim dhe shërbime cilësore në vendin e tyre, e jo të bredhin spitaleve të rajonit duke shkatërruar ekonominë e tyre familjare. Duhet t'i japim fund

fenomenit të eksportimit të pacientëve në vendet e rajonit. Qëllimi i dytë, mjekëve tanë duhet t'u krijojmë kushte teknologjike dhe financiare që profesionin e tyre human ta ushtrojnë në vendin e tyre, e të mos kërkojnë që ta braktisin Kosovën. Duhet t'i japim fund eksportimit të trurit në fushën e mjekësisë", ka deklaruar Veseli. Veseli ka theksuar se Partia Demokratike e Kosovës ka marrë drejtimin e sektorit të shëndetësisë pikërisht për këto qëllime. "Gjatë këtij viti ne kemi dëshmuar se e kemi seriozisht arritjen e tyre dhe në fund të këtij mandati synojmë të kemi një sistem shëndetësor të stan-

dardeve bashkëkohore. Dhe më të mirë se të vendeve të rajonit. Ne mundemi dhe ne do ta bëjmë këtë", është shprehur në fjalën tij kryetari i PDK-së.

Ndërsa ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, njëherësh nënkryetar i PDK-së, ka theksuar se falë mbështetjes së kryetarit Kadri Veseli ka arritur të realizojë shumë projekte të rëndësishme në fushën e shëndetësisë. Ai ka deklaruar se reformat në shëndetësi do të jenë të vazhdueshme, në mënyrë që pacientët të marrin shërbime cilësore shëndetësore dhe personeli shëndetësor të marrë mbështetjen e nevojshme.



Universiteti i Prishtinës promovon 10 doktorantë të rinj



PRISHTINË, 30 TETOR (ER) - Në Sallën e Senatit të Rektoratit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" është mbajtur ceremonia e gradimit të dhjetë kandidatëve në doktorë të shkencave. Kandidatët e shpallur doktorë të shkencave janë nga Fakulteti Filozofik, Filologjik, Juridik, Ekonomik dhe ai i Mjekësisë.

Rektori i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina",

prof. dr. Marjan Dema, gjatë kësaj ceremonie u është drejtuar doktorantëve të rinj me një mesazh, ku ka theksuar se puna me përkushtim e kandidatëve ka bërë që ata të jenë këtu ku janë sot, duke i bërë krenarë jo vetëm familjarët, por edhe universitetin. Ai i përgëzoi doktorantët për suksesin e tyre, teksa i motivoi që të mos ndalen, por ta vazhdojnë tutje rrugën e tyre drejt ngritjes profesionale dhe

kështu t'i shërbejnë edhe komunitetit. Përveç rektorit Dema, të pranishëm në këtë ceremoni ishin edhe prorektori për shkencë në UP, prof. dr. Faton Berisha, dekani i Fakultetit Filozofik, prof. asoc. dr. Bujar Dugolli, dekani i Fakultetit Ekonomik, prof. ass. dr. But Dedaj, dekani i Fakultetit Juridik, prof. asoc. dr. Haxhi Gashi, dekani e Fakultetit të Mjekësisë, prof. dr. Suzana Manxhuka-

Kërliu, dhe prodekanja e Fakultetit Filologjik, prof. ass. Albulena Blakaj.

Në cilësinë e promotorëve të kandidatëve ishin profesorët Muhamet Mala, Rrahman Paçarizi, Gjyljeta Mushkolaj, Fatmir Sejdiu, Visar Morina, Skënder Ahmeti, Arben Dermaku, Lule Raka dhe Nexhmi Hyseni, të cilët i paraqiten rezultatet shkencore të punimit të doktoratave të kandidatëve.

KANDIDATËT E SHPALLUR DOKTORANTË JANË:

Muharrem Qaflehi
Arben Fetoshi
Behar Selimi
Emine Abdyli
Flamur Hyseni
Alban Elshani
Artor Nuhiu
Driton Vela
Rrezarta Bajrami-Halili
Petrit Nuraj

Pacientët nuk po i marrin shërbimet shëndetësore me kohë

Mosfunksionimi i pajisjeve mjekësore ka rezultuar me kohë të gjatë pritjeje për pacientët që kanë nevojë për trajtim. Pritjet për pacientë jospitalorë për Rezonancë Magnetike shkojnë deri në një vit, ndërsa për tomografinë e kompjuterizuar pritjet janë mesatarisht 30-45 ditë

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 30 TETOR - Duke pasur parasysh ndikimin e madh që ka funksionimi dhe menaxhimi i pajisjeve mjekësore në kujdesin shëndetësor, përkatësisht në jetën e qytetarëve, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka ndërmarrë një auditim të performancës për përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit "Përgjegjësia e monitorimit dhe menaxhimit për përdorimin e pajisjeve mjekësore. Rasti: tomografia e kompjuterizuar" i kryer në vitin 2015.

Auditimi përcjellës nxjerr në pah se asnjë nga rekomandimet e dhëna në vitin 2015 nuk janë adresuar plotësisht. Institucionet përgjegjëse, si Ministria e

Shëndetësisë, Shërbimi Klinik Universitar i Kosovës, Qendra Klinike Universitare dhe Spitalet e Përgjithshme në Pejë, Prizren dhe Mitrovicë, nuk kishin përgatitur plane veprimi, duke treguar mungesë të përgjegjësive për ta përmirësuar situatën për menaxhimin e pajisjeve mjekësore dhe ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Besnik Osmani, Auditori i Përgjithshëm, lidhur me këtë auditim ka thënë se ofrimi i shërbimeve me kohë dhe kujdesi shëndetësor ka ndikim të madh në cilësinë e jetës dhe shëndetin e qytetarëve. "Për një sistem shëndetësor funksional, teknologjitë shëndetësore janë thelbësore. Pajisjet mjekësore duhet të menaxhohen dhe monitorohen mirë sepse luajnë rol vendimtar në parandalimin,



diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve si dhe rehabilitimin e pacientëve", ka thënë ai. Vlera e pajisjeve speciale mjekësore në ShSKUK vlerësohet të jetë rreth 8 milionë euro, ndërsa shpenzimet për mirëmbajtje dhe servisim për vitet 2016-2017 janë rreth 4 milionë euro.

Në mungesë të monitorimit dhe

mirëmbajtjes me kohë, ka pasur raste kur disa pajisje ishin jashtë funksionit deri në gjashtë muaj gjatë vitit. Për më tepër, në disa raste kur tomografitë e kompjuterizuara kanë funksionuar jashtë parametrave të rekomanduara nga prodhuesi, duke rrezikuar kështu profesionalizmin e stafit mjekësor.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka vlerësuar se veprimet e deritanishme nuk janë të mjaftueshme, prandaj në rekomandimet e dhëna për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës ka kërkuar që t'i shtojë përpjekjet për adresimin e plotë të rekomandimeve.

Ministria e Shëndetësisë lansoi udhërrëfyesit e parë klinikë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 TETOR - Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka lansuar të martën katër udhërrëfyesit e parë klinikë të cilët kanë për qëllim ngritjen e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore përmes një kujdesi shëndetësor të bazuar në dëshmi. Zëvendësministri i Shëndetësisë, Rustem Musa, ka thënë se sot është ditë pozitive për shëndetësinë, sepse po lansohen 4 nga 8 udhërrëfyesit sa MSh-ja ka hartuar deri më tani. "Duke e parë nevojën dhe urgjencën e hartimit të këtyre udhërrëfyesve dhe protokolleve, MSh ka përcaktuar bazën ligjore për procesin e zhvillimit të udhërrëfyesve dhe protokolleve klinike në vendin tonë përmes Udhëzimit Administrativ 08/2015. Përmes

këtij Udhëzimi janë përcaktuar edhe trupat rregullatore që sigurojnë mbikëqyrje të cilësisë së procesit, duke adaptuar praktikën më të mira mjekësore nga vendet e zhvilluara bazuar në standardet ndërkombëtare. Ky është vetëm hapi i parë në këtë proces i cili duhet të vazhdohet intensivisht me zbatim të tyre në praktikën e përditshme të profesionistëve shëndetësorë", ka theksuar zëvendësministri Musa.

Ndërsa drejtoresha e Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Popullatën (UNFPA), Doina Bologna, ka vlerësuar se udhërrëfyesit do t'u ndihmojnë pacientëve dhe sistemit shëndetësor në Kosovë. "Udhërrëfyesit janë bërë pjesë integrale e sistemit shëndetësor dhe konsiderohen mjete esenciale për ta përmirësuar kujdesin në sistemin primar,



sekondar dhe terciar. Principi kryesor për udhërrëfyesit e bazuar në evidencë është që ta avancoj përkujdesjen klinike në të mirë të pacientëve", ka deklaruar ajo, duke e përgëzuar Kosovën si vend të parë në rajon që bën hapa konkretë në këtë drejtim.

Ndërsa udhëheqësja e Këshillit Kosovar për Udhërrëfyes dhe Protokolle Klinike, Arbëresha Turjaka, ka shpjeguar procesin

e adaptimit të udhërrëfyesve klinikë, duke shpjeguar se arsyeja e fillimit të hartimit të tyre është siguri dhe cilësi dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore të bazuara në dëshmi, duke pasur për fokus gjithmonë interesin e pacientit.

Katër udhërrëfyesit e lansuar janë: Menaxhimi i preeklampsisë së rëndë dhe eklampsisë; parandalimi dhe menaxhimi i hemorragjisë primare postpar-

tale; skriningu dhe trajtimi i lezimeve prekanceroze të qafës së mitrës dhe udhërrëfyesi për shërbime të HIV/testimit. Në proces të botimit janë udhërrëfyesit: Menaxhimi i hipertensionit arterial; Menaxhimi jofarmakologjik i sëmundjes së sheqerit; Menaxhimi i astmës; dhe Transporti neonatal. Procesi i hartimit dhe lansimit të udhërrëfyesve klinikë është përkrahur nga UNFPA.

Prezantohen fazat e zhvillimit dhe ngritjes së kapaciteteve të FSK-së me mision të ri

PRISHTINË, 30 TETOR (ER) - Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rustem Berisha, dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Rrahman Rama, kanë pritur të martën në takim deputetët e Kuvendit të Kosovës, anëtarë të Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së (KPPSMFSK), në krye me deputetin Haxhi Shala, kryetar i Komisionit.

Në takim të përbashkët të deputetëve të Komisionit PPSMFSK të Parlamentit të Kosovës dhe krerëve të Ministrisë dhe FSK-së ishin të pranishëm edhe drejtori dhe zëvendës-drejtori i Ekipit Këshillues dhe



Ndërlidhës të NATO-s për MFSK dhe FSK (NALT). Fillimisht min-

istri Berisha ka falënderuar të gjithë deputetët pa dallime parti-

ake, për përkrahjen dhe votimin që i kanë bërë në parlament

leximit të parë të pakos së projektligjeve për FSK-në dhe Ministrinë e Mbrojtjes.

Në këtë takim informues u bënë prezantime më të hollësishme për pikat konkrete se ku do të ketë ndryshime thelbësore si dhe u prezantuan fazat e zhvillimit dhe ngritjes së kapaciteteve të FSK-së me mision të ri.

Nga deputetët u parashtruan pyetje të ndryshme dhe me interes në të cilat dhanë shpjegimet e tyre ministri, komandanti i FSK-së dhe specialistët e fushës.

Deputetët shprehën falënderimin për mundësinë e dhënë që për pika të ndryshme të projektligjeve të diskutohet konkretisht dhe nga afër.

Nga viti 2019 ndalohet qarkullimi për veturat që ndotin ambientin

PRISHTINË, 30 TETOR - Nga janari i vitit 2019 veturave të cilat shkarkojnë gazra jashtë normave të lejuara do t'u ndalohet qarkullimi, kështu kanë bërë me dije zyrtarë të Ministrisë së Infrastrukturës. Kjo ministri ka nxjerrë një udhëzim administrativ për procedurat e licencimit të kontrolleve teknike, ku parashihet që një veturë e cila i nënshtrohet kontrollit teknik duhet t'i plotësojë edhe disa standarde të caktuara sa i përket ndotjes së ambientit. Një iniciativë e tillë është ndërmarrë nga institucionet e Kosovës në kuadër të masave për mbrojtjen e mjedisit.

Eset Berisha, këshilltar politik në Ministrinë e Infrastrukturës, tha për "Radion Evropa e Lirë" se kanë filluar zbatimin e pilot-projektit të kontrollimit të gazrave që emitojnë veturat. "Ky udhëzim administrativ ka filluar të zbatohet në fillim të këtij viti, por matja e gazrave që emitojnë veturat ka filluar të bëhet në shtator të këtij viti, por për zbatimin e plotë të këtij udhëzimi nevojitet të certifikohen edhe disa inspektues të cilët do të merren me mbikëqyrjen e kontrolleve teknike. Porsa të certifikohen këta inspektore do të fillohet mbikëqyrja e kontrolleve

teknike për zbatim të standardeve sa i përket emetimit të gazrave të përcaktuara me standardet e Bashkimit Evropian", ka theksuar Berisha.

Ai ka treguar se certifikatat me të cilat kufizohet qarkullimi i veturave, të cilat nuk i plotësojnë standardet e nevojshme, nuk kanë filluar të aplikohen ende për arsye se duhet të certifikohen inspektuesit të cilët do të merren me mbikëqyrjen e punës së kontrolleve teknike. Por, sipas Berishës, e gjithë kjo procedurë pritet të përfundojë deri në fillim të vitit të ardhshëm.



Bie numri i ndërmarrjeve të regjistruara në Kosovë

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 30 TETOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Repertorin Statistikor mbi Ndërmarrjet në Kosovë për tremujorin e tretë (TM3) 2018. Në tremujorin e tretë (TM3) 2018 gjithsejtë janë regjistruar 2 212 ndërmarrje. Sipas ASK-së, krahasuar me tremujorin paraprak (TM2 2018) në TM3 2018, ka pasur rënie për 16.1 për qind të ndërmarrjeve të regjistruara. "Po ashtu, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (TM3 2017),

ka pasur rënie të ndërmarrjeve të regjistruara për 0.1 për qind. Aktivitetet ekonomike më të preferuara gjatë këtij tremujori ishin: tregtia me 519 ndërmarrje të regjistruara (23.5 për qind); prodhimi me 214 ndërmarrje të regjistruara (9.7 për qind); akomodimi dhe aktivitetet e shërbimeve me ushqim me 212 ndërmarrje të regjistruara (9.6 për qind); ndërtimtaria me 189 ndërmarrje të regjistruara (8.5 për qind); aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike me 182 ndërmarrje të regjistruara (8.2 për qind); informimi dhe komunikimi

me 149 ndërmarrje të regjistruara (6.7 për qind); bujqësia, pylltaria dhe peshkataria me 145 ndërmarrje të regjistruara (6.6 për qind); ndërsa aktivitetet e tjera marrin pjesë në shkallë më të vogël", është thënë në njoftimin e ASK-së. Sipas ASK-së, në kategorinë me 1 deri në 4 të punësuar janë gjithsejtë 2 149 ndërmarrje të regjistruara në këtë tremujor (97.2 për qind); me 5 deri 9 të punësuar janë 41 ndërmarrje të regjistruara (1.9 për qind); me 10 deri në 19 të punësuar janë 15 ndërmarrje të regjistruara (0.7 për qind); me 20 deri 249 të punësuar janë 7 ndër-



marrje të regjistruara (0.3 për qind); ndërsa në kategorinë me 250 e më shumë të punësuar nuk ka asnjë ndërmarrje të regjistruar gjatë këtij tremujori. "Sa i përket shtrirjes gjeografike të ndërmarrjeve të regjistruara në nivel të komunave, ashtu si në çdo

tremujor, mbizotëron komuna e Prishtinës me 649 ndërmarrje të regjistruara (29.3 për qind); Ferizaj me 187 ndërmarrje të regjistruara (8.5 për qind); Prizreni me 162 ndërmarrje të regjistruara (7.3 për qind); Gjilani me 134 ndërmarrje të regjistruara (6.1 për qind); Peja me 113 ndërmarrje të regjistruara (5.1 për qind); Mitrovica me 92 ndërmarrje të regjistruara (4.2 për qind); ndërsa komunat e tjera kanë numër më të vogël të ndërmarrjeve të regjistruara në këtë tremujor", është thënë në raportin e ASK-së.

Mundësi për partneritete të reja ndërmjet bizneseve të Kosovës dhe ShBA-së

PRISHTINË, 30 TETOR (ER) - Delegacioni i bizneseve të Kosovës, i cili qëndroi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), nën organizimin e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, ka vizituar edhe shtetin e Nju Jorkut, me ç'rast ka zhvilluar takime me përfaqësues të asocioneve të biznesit, organizata të inovacionit dhe ndërmarrësisë, si dhe biznese individuale në këtë shtet amerikan.

Delegacioni i bizneseve nga Kosova, i udhëhequr nga drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane dhe në shoqërim të konsullës së përgjithshme të Republikës së Kosovës në Nju Jork, Teuta Sahatqija, u takua me Yvonne Bendinger-Rothschild, drejtoreshë ekzekutive e Odës Ekonomike Evropiane-Amerikane me seli në Nju Jork. Në takim u diskutua për progresin e shënuar në Kosovë në aspektin e të bërit biznes, por

edhe lidhur me kërkesat që kompanitë e Kosovës kanë për investitorët amerikanë, ndërsa Bendinger-Rothschild u zotua për mbështetje të kompanive kosovare, përfshirë edhe gjetjen e partnerëve afaristë. Me mbështetje të Konsullatës së Përgjithshme të Kosovës delegacioni pati mundësi të vizitojë edhe organizatën SAP Next Generation në Nju Jork e cila drejton programin e inovacionit

dhe ndërmarrësisë që, mes të tjerash, angazhohet edhe për implementimin e synimeve të zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara. Aty u pritën nga zëvendëspresidentja Ann Rosenberg, e cila sqaroi për punën e jashtëzakonshme që bëhet në atë qendër për nxitjen e inovacioneve. Ajo ka premtuar edhe përkrahjen e saj për zhvillimin e një programi të ngjashëm edhe në Kosovë.

Konsullata e Përgjithshme e Republikës së Kosovës organizoi edhe një pritje për bizneset nga Kosova të cilët përfaqësonin sektorë si prodhimi, tregtia, shërbimet konsultante të biznesit, shërbimet e teknologjisë së informacionit, por edhe profesionistët dhe ndërmarrësit shqiptarë, anëtarë të Rrjetit të Profesionistëve dhe Ndërmarrësve Shqiptarë me seli në Nju Jork.



Mungesa e standardeve në shërbimet publike, problem serioz për bizneset në Kosovë

PRISHTINË, 30 TETOR (ER) - Ulja e cilësisë së shërbimit për konsumatorët është një nga problemet kryesore me të cilat po përballen operatorët kabllorë në komuna të ndryshme të Kosovës, u tha në takimin e përfaqësuesve të Odës së Afarizmit të Kosovës me përfaqësuesit e operatorëve kabllorë "Ipko", "OrangeNet" dhe "Kujtesa". "Vendosja e ndriçimit publik në rrugët e qyteteve, duke

shpërfillë standardet evropiane, e cila ka si pasojë lirim të fushës magnetike që po kalon në kabllot e operatorëve kabllorë, po ndikon në ulje të cilësisë së shërbimit, gjë që, përveç dëmtimit të bizneseve, njëkohësisht po dëmton edhe konsumatorët", ka thënë përfaqësuesi i "Ipko"-s, Lavdrim Sadiku. Ai ka shtuar se edhe pse kanë realizuar takime me drejtorin e shërbimeve publike të

Komunës së Ferizajt, me të cilin janë marrë vesh që operatorët kabllorë të blejnë filterat e nevojshëm, ndërsa vendosja e tyre të bëhet nga kontraktori për ndriçim publik, kjo marrëveshje nuk po respektohet. Vedat Morina, përfaqësuesi i "OrangeNet", ka pohuar se operatorët kabllorë janë duke realizuar veprimtarinë e tyre me humbje si pasojë e problemeve



me të cilat po përballen. Përfaqësuesi i "Kujtesës", Amir Kranski, ka theksuar se, përveç Komunës së Ferizajt, këtë prob-

lem po e hasim edhe në komuna të tjera, ndër të cilat Prishtina, Fushë-Kosova, Obiliqi, Shtërpca, Kaçaniku etj. Kryetari i bordit të OAK-së, Skënder Krasniqi, ka thënë se kjo odë do ta përkrahë çdo kërkesë e cila ndikon në përmirësimin e klimës së të bërit biznes në Kosovë, duke shtuar se angazhimi nuk do të mungojë edhe për problemin e adresuar.



FMN-ja shpalosi shqetësimet për projektbuxhetin e 2019-s

Ministri i Financave, Bedri Hamza, në një konferencë të përbashkët për medie me përfaqësuesit e FMN-së, ka thënë se projektbuxheti për vitin 2019 është bazuar në rritjen ekonomike, përderisa ka paralajmëruar rritje të pensioneve. Ndërkaq udhëheqësja e Misionit të FMN-së për Kosovë, Stephanie Eble, ka thënë se presin rritje ekonomike katër për qind që, sipas saj, është rritja më e lartë në rajon. Mirëpo ka theksuar se përsëri mbetet një rritje e cila nuk e zë hapin e zhvillimit të vendeve në rajon

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 30 TETOR - Misioni i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) ka përfunduar vizitën në Kosovë, anëtarët e të cilit kanë zhvilluar një sërë takimesh me përfaqësues të lartë dhe ekspertë të institucioneve qeveritare. Me këtë rast, ministri i Financave (MF), Bedri Hamza dhe udhëheqësja e Misionit të FMN-së për Kosovë, Stephanie Eble, kanë mbajtur një konferencë të përbashkët për medie. Ai ka thënë se për-

faqësuesit e FMN-së kanë diskutuar për ecurinë e buxhetit aktual, buxhetin për vitin e ardhshëm dhe për nenin e katërt të ligjit i cili rregullon çështjet e Qeverisë me FMN-në. Sipas tij, presin që buxheti aktual të përmbushet në masë 98-99 për qind. Po sipas tij, pritet që deficitin buxhetor të jetë më pak se 2 për qind në fund të vitit. "Jemi të detyruar t'i bëjmë disa ndryshime në buxhet sepse është e domosdoshme sepse kemi lëvizje buxhetore", është shprehur ai.

Hamza ka vlerësuar se dallimet

në parashikimet ekonomike në mes të FMN-së dhe Qeverisë janë shumë të vogla, rreth 30 milionë euro. "Sa iu përket projeksioneve ekonomike, FMN-ja është pak më ulët se ne, e vlerësojmë këtë, por dallimet janë shumë simbolike. Kemi dallime simbolike edhe rreth projeksioneve. Ne e kemi miratuar buxhetin me një diferencë simbolike. Janë disa milionë euro që kemi dallim te projeksionet, por kjo nuk e ndryshon qasjen e përbashkët. Dallimin e kemi për rreth 30 milionë euro që duhet të jenë më pak të hyra të planifikuara", ka thënë Hamza. Sipas tij, është e mirëpritur nga FMN-ja fakti se u është dhënë prioritet rendit dhe ligjit, shëndetësisë, arsimit.

Hamza ka thënë se Kosova qëndron mirë në aspektin fiskal por kjo, sipas tij, nënkupton që të ndërmerren veprime që kanë kosto. Udhëheqësja e Misionit të FMN-së për Kosovë, Stephanie Eble, ka thënë se presin rritje ekonomike katër për qind që, sipas saj, është rritja më e lartë në rajon. Mirëpo,

ka theksuar se përsëri mbetet një rritje e cila nuk e zë hapin e zhvillimit të vendeve në rajon. "I kemi disa shqetësime për projektbuxhetin për vitin 2019, për të hyrat dhe fondin për veteranët. Nga ana e shpenzimeve për kategoritë sociale duhet të vazhdojë reforma", ka deklaruar Eble, duke shtuar se projektligji për pagat duhet të rishqyrtohet ngaqë nuk trajton "Punë të barabartë për pagë të barabartë".

Ndërsa guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka falënderuar Fondin Monetar Ndërkombëtar për përkrahjen e vazhdueshme që i ka dhënë Kosovës, në veçanti BQK-së, për realizimin e objektivit të saj primar, mbrojtjen dhe ruajtjen e stabilitetit financiar. Ai ka deklaruar se sektori financiar po vazhdon me performancë pozitive. "Sektori financiar vazhdon të ketë rritje të vazhdueshme dhe në këtë kontekst, nëse shohim sektorin bankar, ka shënuar rritje në të gjithë treguesit

financiarë, si në rritjen në kredi, ku rritja në bazë vjetore është 12 për qind, në depozita 6 për qind, po ashtu edhe në asete 6 për qind. Në kontekstin rregullativ, treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit shënojnë rritje në 16.1 për qind, që është mbi minimumin e kërkuar rregullativ. Gjithashtu, raporti i likuiditetit prej 33 përqindësh është mbi minimumin e kërkuar rregullativ prej 25 përqindësh. Këto të dhëna tregojnë se bankat janë mirë të kapitalizuara dhe likuide. Po ashtu, zhvillime pozitive kemi edhe në normën e interesit, ku norma e interesit për bizneset dhe ekonomitë familjare është 6,3 për qind, ndërsa nëse e shohim normën e interesit vetëm për biznese, është 5.35 për qind, përderisa norma e interesit për kreditë hipotekare sillet prej 4 përqindësh deri në 5 për qind. Kjo tregon për lehtësimet që janë bërë në qasjen në financa dhe njëkohësisht të kemi edhe rritje të shkallës së ndërmjetësisimit financiar", ka deklaruar Mehmeti.

GIZ-i do të vazhdojë ta mbështesë ATK-në

PRISHTINË, 30 TETOR (ER) - Drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Sakip Imeri, ka pritur në takim ekspertët e rinj nga projekti i GIZ-it, të cilët do të vazhdojnë ta përkrahin ATK. Në takim u diskutua për aktivitetet e reformës në ATK për tre vjetet e ardhshëm dhe për mundësitë e kontributit të ekspertëve në realizimin e tyre. Gjithashtu, në

takim u potencua edhe një herë se bashkëpunimi në të ardhmen do të jetë në aspektin e nivelit strategjik, ku ekspertët me përvojën e tyre do ta ndihmojnë ATK-në në planifikimin e resurseve dhe në organizimin e aktivitetëve në të ardhmen, që kjo e ka kuptimin e asaj se përkrahja e deritanishme nga GIZ-i ka qenë në aspektin e krijimit të mekanizmave për ngrit-

jen e përmbushjes së obligimeve tatimore dhe tani do të vazhdohet me transformimin e tyre në nivele strategjike. ATK-ja ka një bashkëpunim me GIZ-in prej disa viteve. Fushat e bashkëpunimit kanë qenë për ngritjen e kapaciteteve të stafit lidhur me kontrollin tatimor, legjislativonin e TVSh-së dhe shumë fusha të tjera për ngritjen e përmbushjes vullnetare.



Hani i Elezit njoftohet me projektet e MCC-së

HANI I ELEZIT, 30 TETOR (ER) - Nën kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, Mallzum Qajani, ka pritur në takim pune zyrtarë nga Fondacioni i Mileniumit të Kosovës, përfaqësuar nga drejtori ekzekutiv i këtij fonacioni, Petrit Selimi, Sarah Olmstead, drejtoreshë e MCC-së për Kosovë dhe Burim Hashani, drejtor i Programit të Energjisë. Në takim ishin të pranishëm edhe Refet Kalisi, drejtor i Shërbimeve Publike, Menduh Vlasi, drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe Nexhmedin Daci, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Kadastër.

Drejtori ekzekutiv i Fondacionit të Mileniumit të Kosovës, Petrit Selimi, ka bërë me dije se qëllimi i kësaj vizite ka të bëjë me prezantimin e këtij fonacioni dhe përfitimet e mundshme nga mbështetja që ky program ofron për përmirësimin e efikasitetit energjetike. Selimi ka thënë se Fondacioni i Mileniumit i

Kosovës është entitet implementues i programit Threshold në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Millennium Challenge Corporation, që është agjenci e pavarur e ShBA-së për mbështetje në luftën kundër varfërisë globale.

Programi Threshold në Kosovë synon t'i trajtojë pengesat për zhvillimin ekonomik, ku furnizimi i sigurt me energji elektrike është identifikuar si një ndër pengesat kryesore. Ky projekt përmes aktiviteteve pilotuese ka për qëllim ta mbështesë rritjen e efikasitetit energjetike në ndërtesat e banimit, si dhe kalimin në ngrohje që nuk bazohet në energji elektrike. Në kuadër të projektit parashihet edhe mbështetja e zhvillimit të sektorit privat që ofron shërbime në fushën e efikasitetit energjetike, duke përfshirë edhe avancimin e pozitës së grave dhe kategorive të cenueshme sociale.



Familja Dervishi, përfituese e projektit për ndërtimin e stallës së bagëtive


SKENDERAJ, 30 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, nënkryetari Nuredin Lushtaku dhe drejtori i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Sokol Sallahu, kanë vizituar fermën e lopëve, pronë e familjes Dervishi nga Kostërci i kësaj komune, e cila është përfituese e projektit për ndërtimin e stallës së bagëtive. Jashari ka thënë se familja Dervishi nga Kostërci është shembull i mirë i punës dhe angazhimit familjar, që nëpër-

mjet blegtorisë të zhvillohen ekonomikisht si familje dhe shtim të të mirave materiale e ekonomike nga ky sektor. "Kjo familje që ka fermë të lopëve qumështore është përfituese e projektit për ndërtimin e stallës për 30 krerë lopë gjithsejtë. Së bashku me nënkryetarin Lushtaku dhe drejtorin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Sokol Sallahu, kemi vizituar këtë fermë dhe u ndava i lumtur me punën e bërë për ndërtimin e fermës, që pritet

të përfundojnë brenda tri javëve. Familja Dervishi ka pasur fat të keq muaj më parë, pasi i janë djegur gjashtë krerë lopë brenda stallës. Qeveria ime është e përkushtuar t'i mbështesë sektorët e bujqësisë, ashtu siç bëmë pak javë më parë, me subvencionim të fermerëve me makina mjelëse dhe për bletarë me koshere. Ndihami jonë për bujqit e Komunës së Skenderajt do të vazhdojë pa u ndalur", ka thënë Jashari.



n'fermë



Mendo për nesër, blej produkte vendore!

Prishtina për herë të parë hap panairin e prodhimeve vendore bujqësore

PRISHTINË, 30 TETOR (ER) - Për herë të parë në Komunën e Prishtinës do të hapet panairi i prodhimeve vendore bujqësore. Kjo komunë ka bërë me dije se ky panair do të jetë i hapur nga 1 deri më 3 nëntor, ku prodhuesit mund t'i ekspozojnë prodhimet e tyre. "Ekonomitë

familjare dhe ndërmarrjet bujqësore prodhuese e përpunuese të territorit të Prishtinës do t'i ekspozojnë prodhimet e tyre, me ç'rast vizitorët e panairit do të njoftohen për së afërmi me prodhimet vendore. Nën moton 'Mendo për nesër, blej produkte vendore', ky

panair ka për qëllim t'i promovojë prodhuesit bujqësorë vendorë, ashtu që të kemi zhvillim rural të qëndrueshëm. Panairi do të jetë i hapur më 1, 2 dhe 3 nëntor në Sheshin 'Zahir Pajaziti' në Prishtinë", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.

Nis rregullimi i kanalit për shkarkimin e ujërave atmosferike

THERANDË, 30 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Therandës, Bali Muharremaj, ka marrë pjesë në fillimin e punimeve për rregullimin e kanalit për shkarkimin e ujërave atmosferike të rruga e Reqanit. Me këtë rast, Muharremaj ka kërkuar angazhim maksimal për rregullimin e këtij kanali. "Po bëhet rregullimi i kanalit për

shkarkimin e ujërave atmosferike nga Rruga 'Xhavit Sylja' (Rruga e Reqanit) në Lumin 'Toplluha'. Duhet të angazhohemi sistematikisht për rregullimin e punimeve të mbetura ngaqë zgjidhja e problemeve për këtë zonë ekziston tash e sa kohë. Unë do të jem në terren, i gatshëm për përkrahje kudo ku ka vullnet për punë", ka thënë Muharremaj.



Në bazë të cilave vlera mbahen të izoluar më pak se dy milionë shqiptarët e Evropës?

Nga Jakup KRASNIQI



Mediet tona më 29 tetor 2018 njoftuan publikun se liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës nuk pritet të ndodhë as në fund të këtij viti se: "Bashkimi Evropian është bllokuar për shkak të hezitimit të shumë shteteve anëtare të këtij unioni. Në takimin e fundit të mbajtur nga ambasadorët e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, i njohur si COREPE, është dëshmuar se 12 ose 13 shtete të BE-së ende hezitojnë ta mbështesin një vendim të tillë". Të fuqishmit mund ta bëjnë këtë, por mbi bazën e cilave vlera e bëjnë këtë? Të fuqisë? Të drejtësisë? Të humanizmit? Apo pse po ju dhimbset ndëshkimi i politikave millosheviqiane të gjenocidit? (Fjala është për vendet që po e pengojnë liberalizimin e vizave për qytetarët më të përvuajtur të Evropës gjatë gjithë shekullit XX)? Sigurisht se ky lajm nuk është i

mirë vetëm pse qe dy dekada po mbahen të izoluar si në geto (vendet e BE-së jo pak herë kanë treguar gatishmëri për të luftuar çdo formë të getoizimit), më pak se dy milionë qytetarë të Kosovës të cilët në 50 vjetët e fundit në vendet e BE-së kanë imigruar për shkaqe politike e ekonomike mbi një milion familjarë të tyre të cilët me djersën e tyre kanë ndihmuar në zhvillimin e atyre vendeve dhe zhvillimin e atyre vendeve e ndihmojnë edhe sot. Nuk është i mirë as për faktin pse me vendimet e Fuqive të Mëdha në fillim të shekullit XX e krejt deri në qershorin e vitit 1999, kjo pjesë e kombit shqiptar jetoi e gjallëroi nën thundrën e shovinizmit serb, duke hequr të "zitë e ullirit", gjatë së cilës kohë disa herë përjetoi holokaustin e egër dhe gjenocidin serb (1998/99), për çka në fund të shekullit XX ndodhi ndërhyrja ushtarake ndërkombëtare për

shkak të krizës së rëndë humanitare të shkaktuar nga makineria ushtarake e policore e Serbisë, pjesë e se cilës makineri ishin edhe drejtuesit e sotëm të Serbisë. Mbi të gjitha, nuk është lajm i mirë, pse disa vende, dhjetë a më shumë sish, i kanë bllokuar më pak se dy të tretat e këtij popull për të lëvizur të lirë në zonën shengen. Nuk e di, ky izolim i njerëzve më të varfër të Evropës mbi bazën e çfarë vlerave njerëzore, demokratike dhe humanitare është duke u bërë? A është në përputhje ky izolim me të drejtat e liritë e njeriut dhe vlerat evropiane?

Nëse mbahen të izoluar pse në Kosovë nuk sundon rendi e ligji i cili vjen si pasojë e mosfunksionimit të sistemit joefikas të drejtësisë, këtu nuk mund të amnistohet as BE-ja e cila e ka pasur hisen e saj deri dje, kur kishte trupën e saj të njohur si EULEX dhe nuk pati ndonjë

funksionim të mirëqenë, në të tri fushat ku kishte për disa vite edhe kompetenca ekzekutive. Pastaj, për gati dhjetë vjet, gjatë administrimit ndërkombëtar në Kosovë, kishte kompetenca në zhvillimin ekonomik e privatizimin e pasurisë publike e shoqërore, pasojat e së cilës politikë janë të pranishme edhe sot. Vendet e BE-së i kishin kompetencat edhe në ndërtimin e Administratës Publike si dhe në procesin e arsimit e të shëndetësisë. Në të gjitha këto fusha edhe sot e kësaj dite ka jo pak probleme e, mbase, edhe ndërhyrje nga të gjitha anët. Vendet e Demokracisë Perëndimore, thënë më së buti, i mbyllën sytë dhe lejuan që procesi i arsimit dhe i shëndetësisë t'u bëheshin target bizneseve përfituese e jo segmente të dijes e shëndetit cilësor publik?! Madje që sa vite është ndërtuar një Gjykatë Speciale e cila nuk është duke premtuar as


azhuritë e as funksionalitet dhe e cila nuk pritet që do të ketë ndonjë profesionalizëm ndryshe nga pararendëset e saj (UNMIK-u e EULEX-i). Ndonëse, edhe ajo është krijuar mbi bazën e politikave serbe që në Evropë është përçarur nga miqtë e Serbisë.

Qytetarët e Kosovës edhe mund të mbahen të izoluar dhe, po mbahen të izoluar bash ata qytetarë që më se paku e meritojnë këtë izolim në varfëri! Ato grupet e tjera, të trafiqeve të ndaluara e të kimit të organizuar, që nuk shquhen për ndershmëri, nuk po ka kufi në Evropë që i ndalon. Ndalimi po u bëhet njerëzve të ndershëm dhe atyre që do të ishin shpresa e progresit dhe e zhvillimit me punë e djersë.

Të shpresojmë e të besojmë se vlerat e proklamuar në flamurin e BE-së do të triumfojnë mbi dobësitë e çastit të këtij apo atij vendi anëtar të atij bashkimi shpresëdhënës!

Çka tregojnë veprimet luftënxitëse të Serbisë?

Ramadan QEHAJA



Ashtu siç është theksuar në shumë raste më herët, Serbia aktuale e Vuçiqit nuk e ka bërë asnjë hap në drejtim të demokratizimit të shoqërisë. Krahas shumë shembujve që tregojnë regres shoqëror në liritë më bazike siç janë mediet, shembulli më tipik i kultivimit të mëtejshëm të qasjes agresive (luftarake), në veçanti ndaj Kosovës, është edhe mundësia që ua dha Ministria e Mbrojtjes e Serbisë kriminelëve serbë për t'i promovuar librat e tyre. Këtu vlen të përmendet veçanërisht promovimi i ditarit luftarak të kriminelit të luftës,

gjeneralit Nebojsa Pavkoviç, i cili shpërfaqti mburrjen e tij për organizimin e rezistencës ndaj sulmeve të NATO-s dhe foli me krenari për krimet që ka bërë ai dhe njësitet e tij ndaj popullit shqiptar të Kosovës në vitet 1998/99. S'do mend se i dënuari si kriminel luftime në Kosovë me 22 vjet burgim nga Tribunali i Hagës, gjenerali Pavkoviç, edhe më tej promovon në esencë "nevojën" e luftës së vazhdueshme kundër popullit shqiptar. Ditari i tij i luftës përbën dëshmi për këtë.

Kujtoj se tentativat e BE-së për ta pranuar Serbinë në gjirin e saj nuk prodhuan dhe

asnjëherë nuk do të prodhojnë distancim të saj nga e kaluara kriminale ndaj popullit shqiptar. Jo vetëm kaq. Opinioni tonë i kujtohet edhe ligjërimi që bënë gjeneralët serbë e që vazhdojnë të bëjnë në shkollat dhe akademitë ushtarake që ishin të dënuar për krime luftime në Kosovë. Atëbotë, përveç një kundërvënies diplomatike të një pjese të bashkësisë ndërkombëtare, nuk u vërejt ndonjë ndikim pozitiv për stabilizimin aktual politik e ushtarak serb.

Nëse e bëjmë një vështrim, qoftë edhe sipërfaqësor të veprimeve të Beogradit zyrtar

në dëm të shtetndërtimit të Kosovës dhe popullatës së saj, atëherë nuk është e vështirë që të konkludohet se ajo nuk ka arritur që të dalë nga e kaluara e saj e errët. Me fjalë të tjera, për vetë faktin se nuk është ballafaquar asnjëherë me të kaluarën, tanimë rajoni po i vuan konsekuencat e rilindjes së nacionalizimit në Serbi. Deklarimet e kohëpaskohshme të disa politikanëve tanë, se Serbia, për shkak të "orientimit" të saj pro evropian, më nuk paraqet rrezik për Kosovën dhe rajonin, janë të pabaza. Nëse asgjë tjetër, atëherë përdorimi i Ushtrisë Serbe për shkëputjen e

veriut të Kosovës mund të jetë real, aq më parë që në atë pjesë të territorit tanë nuk e kontrollojmë tërësisht.

Së fundi presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në disa raste ka theksuar "rrezikshmërinë" për Serbinë dhe rajonin nga mundësia e formimit të ushtrisë së Kosovës, në kontekst të arsytimit të një gatishmërie të lartë luftarake të Serbisë për t'u mbrojtur, siç e thonë ata, hapur "nga terroristët shqiptarë".

Marrë në tërësi, nuk po shihet në horizont ndonjë sinjal pozitiv nga Serbia zyrtare për normalizimin e marrëdhënieve në mes të dy shteteve.

Mafia nigeriane në Itali: Heroinë e verdhë, prostitucion dhe lëmoshë

I quajnë “kult”, dominojnë raketat nga Torino në Palermo. Lidhjet me klanin Ballarò. Nënvlërësimi i një fenomeni shqetësues dhe të përhapur në zonë

Nuk do të jetë ende kontroll i territorit. Por prita e shtatorit të vitit të kaluar në kopshtet e Alimondës në Torino kundër dy policëve anti-drogë të rrethuar dhe rrahur nga rreth tridhjetë tregtarë të drogës afrikane shkon shumë pranë nesh. Ne jemi në mes të Aurorës dhe Barriera të Milanos, pranë këtij kursi aq multietnik Giulio Cesare që tregtarët e fundit lokalë shohin kartelën shenjën “Dyqani italian”. Ne jemi në mes të Aurorës dhe Barriera të Milanos, pranë këtij kursi aq multietnik Giulio Cesare që tregtarët e fundit lokalë shfaqin shenjën “Dyqani italian”. Mafia nigeriane komandon këtu: dhe jo vetëm këtu.

Kult

“Kam bërë tre raporte për tre prokura të ndryshme, Roma, Bolonja dhe Palermo, të interesuar për fenomenin që po përhapet si zjarri në Itali dhe në të gjithë Europën”, ka thënë komisionari komunal, Fabrizio Lotito për komisionin parlamentar në periferi, i cili ka punuar me prokurorin e Torinos. Hierarkia, ritet e fillimit, të ashtuquajturat “kult”: “Torino është qyteti me numrin më të madh të emigrantëve nigerianë, dhe ndiqet nga Emilia Romagna. Hetimet tona për këtë fenomen të mafias shohin si aktorë kryesorë “kultin” nigerian, të lindur në universitetet nigeriane të viteve gjashtëdhjetë, pastaj evoluuar jashtë dhe arritur edhe në Itali: ata kanë një strukturë vertikale dhe nga hetimet, ne kemi qenë në gjendje të përshkruajmë 416 bis, shoqatën e mafias”.

Viktimat

Black Axe, Maphite, Supreme Eiyee Confraternity, Ayeje janë emra të “kultit” që kanë mbushur kronikat tona për vite; lidhja e tyre si pika në një fletë ndoshta do të tregonte një dizajn më të madh dhe të turpshëm


për një ndjenjë të keqkuptuar të korrektësisë politike: për të debatuar publikisht mbi mafiozët nigerianë ofron argumente për racistët tanë? E kundërta është e vërtetë, sepse viktimat e para të “donit” (udhëheqësit kultistë) janë vajzat nigeriane që shiten si sklave në Domizian dhe të rinj nigerianë (“kapak bejsbolli”) të reduktuar në lypje para godinave të Romës ose Milanit për të shlyer borxhet e kontratave familjare në Nigeri.

Trafikim milioner

Nga veriu në jug të Italisë kështu avancojnë mafia e pestë (pas Cosa Nostra, ‘Ndrageta, Camorra dhe pulieze Sacra Corona) me trafikimin e saj milionerësh të kokainës nga Kolumbia në Kanada, heroina e re “e verdhë” kaloi në Veri-Lindjen tonë dhe liderët e veshjeve u vendosën gjithmonë në qytetin Benin, i cili mbetet kompania mëmë dhe është për “kultin” siç San Luca do të ndriçojë. Teknikët dhe puristët do të thoshin se mafia është e shumtë për të bërë renditje, nga rusët te shqiptarët, nga kinezët te mafia romake shumëformëshe. Komisioneri Lotito gjithashtu ankohet se mafia nigeriane shihet “më shumë si një problem i rendit publik”. Një gabim vlerësimi, sepse asnjë mafie e re nuk ka përhapjen e saj: një mijë bashkëpunëtorë të vlerësuar në Itali (rreth 93 mijë emigrantë nigerianë), të paktën njëzet qytete (Torino dhe Bolonja në krye) dhe dhjetë rajone të përfshira në rrjetin e saj që numëron rreth tridhjetë mijë bashkëpunëtorë në mbarë botën në dyzet shtete.

Nga qyteti i Beninit në Palermo

Në Itali, mafia nigeriane ka mësuar të lëvizë në mënyrë strategjike. I famshëm është një përgjim në burg midis dy mafias të klanit Di Giacomo mbi bosët e



Ballarò, qendra e Palermos. “Atje janë turqit” (që do të thotë njerëz të ngjyrosur). “Cilët”. “Nigerianët ... por ata janë të respektueshëm dhe pastaj ... (një frazë që për hetuesit do të kishte një kuptim të saktë: Nigerianët e Black Axe mbajnë lojëra të mëdha të drogës me Cosa Nostra). Në Jug, ku mafiozët autoktonë mbajnë kontrollin ushtarak, mafia që vjen nga qyteti i Beninit kërkon marrëveshje, si në Ballarò. Në veri bie rëndë: në vitin 2017, nga 12.387 vepra të nënshkruara nga kriminaliteti nigerian (një e pesta e atyre të kryera nga të gjithë të huajt), në veri ndodhen 8.594, 1.675 në Qendër, 1.434 në Jug dhe 684 në ishujt.

“Ata nuk kanë respekt për jetën”

Torino është teatri i operacionit Athenaeum të Carabinieri, që fotografon lidhjen mes Maphite dhe Eiyee. Giovanni Falconieri në Corriere di Torino i tha një të penduari i cili i përshkruan Maphitët me terma tronditës: “Ata u ulën në Lampedusa dhe njerëzit kanë frikë prej tyre ... Ata nuk kanë respekt për jetën, tash-

më kanë vuajtur shumë për të shkuar në Itali”. Tani del nga çështja e uljeve të ndotura nga mafia e qytetit Benin. Gjyqtari i Torinos Stefano Sala, në pothuajse 700 faqe të rendit, motivon dënimet për 21 anëtarë të Eiyee dhe Maphite, dhe ndriçon një fener: “Modulet operative të shoqatave kriminale nigeriane janë transferuar në Itali në rast të rrjedhave masive migratore që ne dëshmojmë në këto vite” (...) midis emigrantëve të sapo zbritur, rekrutuan korrierët që gëlltisnin kokainën”.

Paga e shefave

Një “don”, kreu i strukturës lokale, mund të marrë një pagë prej 35 mijë eurosh çdo tre muaj. Subjekti i vogël territorial është “zona”, që ngrihet deri në “tempull” deri në “tempullin e vrasjes” të Beninit, ku strategjia politike është përpunuar. Ato duken si minuta e parë e Buscetta-s të shpëlarë në globalizim. Nëse Torino është qyteti ynë më i përhapur nga migrimi nigerian, Bolonia konsiderohet “kryeqyteti” i kultizmit, dyqani në Bologninë qendrore dhe në periferi ka qenë në duart e Axe së

Zeze për vite. Por ordinancat që shumohen, me veprimet e policisë, përshkruajnë një valë shumë më të gjatë: Black Axe, në Palermo, 2016, në grupin e Ballarò; Aquile Nere, Caserta, të njëjtin vit. Kultet, në Romë, 2014. Niger, Torino 2005. Ende Black Axe, Castello di Cisterna, Napoli, 2011.

Skllëvërit

«Ne kemi lindur të vdekur», skllëvërit nigerianë të Domizianit i tregojnë sociologut Leonardo Palmisano në një libër pranë daljes, «Axe e Zeze». Ato janë “akset e zeza”, mafia që premtonte vdekjen në Palmisano, tepër kokëfortë për të hetuar trafikun. Djemtë që erdhën nga qyteti i Beninit tani ndihen mjaft të fortë për këtë të fundit, hap kërcënues. Shumë ujë ka kaluar që nga ky alarm i vitit 2011: “Dëshiroj t’ju tërheq vëmendjen tuaj në veprimtarinë e re kriminale të një grupi të nigerianëve që i përkasin sekteve sekrete ... të aftë për të hyrë në Itali kryesisht për qëllime kriminale”. Jo deliriumi i një ksenofobie të trashë, por informacioni i ambasadorit nigerian në Romë.

(gazeta-Shqip.com)

E jashtëzakonshme

Gruaja nga Uganda që ka lindur 44 fëmijë

Shumica e çifteve të reja vendosin të bëjnë një ose dy fëmijë për shkak të dinamikës së jetës dhe vështirësisë për t'i rritur ata. Por çfarë do të thoshin nëse do t'i kishin 38 fëmijë? Kjo nuk është shaka. Një grua tani 39-vjeçare nga Uganda ka lindur 44 fëmijë, gjashtë nga ta i humbi, tani në një çati jetojnë 38 fëmijët e saj.



FOTO E DITES



Pamje të dy stinëve vjeshtë-dimër. Foto e realizuar në Pejë nga Granit Dinaj.

E rrallë

Piceria e cila ofron 500 euro në rast se hani picën prej 81 centimetrave

Piceria Pinheads në Dublin ka ofruar një çmim marramendës nëse mund të hani një picë prej 81 centimetrave të shoqëruar me dy "milkshake" në të njëjtën kohë. Pronari i picerisë, Anthony Kelly, ka thënë se askush nuk do ta kalojë këtë sfidë.



"Deri më tani e kanë provuar mbi 100 njerëz, por askush nuk ka fituar", ka deklaruar ai. Personi i fundit i cili e sfidoi veten ishte një gazetar i cili arriti të hante një të katërtën e picës brenda 35 minutave, por pa asnjë milkshake.

BARSOLETA E DITËS



E ndalon polici vozitësin dhe i thotë:
- O jaran, është e katërta herë që po të ndali dhe po të them që diçka po të rrjedhë nga makina!
Vozitësi ia kthen:
- Edhe unë që kaq herë po të them se kjo është cisternë për pastrimin e rrugëve!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

"ALPHA" 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

"JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN"

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

"NIGHT SCHOOL"

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

"SIBERIA",

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

"VENOM" 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics




Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI
Këtë ditë çdo fushë e jetës suaj do të përmbushet më së miri. Energjia pozitive do të jetë ngado në ajër dhe gjërat do të zgjidhen vetë.



DEMI
Ndieni që disa iniciativa tuajat janë bllokuar dhe nuk po dini si të veproni. Duke shmangur debatet, thjesht do ta lini punën tuaj të papërfunduar.



BINJAKËT
Po luani rolin e viktimës kur në të vërtetë ju nuk jeni të tillë. Mundohuni të hiqni dorë sa më shpejt nga kjo sjellje.



GAFORRJA
Jeni racional sot në ato që ndodhin dhe e kuptoni që jo gjithmonë njerëzit tuaj të afërt kanë të drejtë.



LUANI
Një udhëtim i papritur do t'i ndryshojë të gjitha planet e ditës suaj. Duhet të shtyni për më vonë çdo gjë që kishit menduar të bënit.



VIRGJËRESHA
Keni qejf të rriini në shoqëri të mirë sot dhe në mbrëmje mbase të lexoni një libër të bukur. Ju mungojnë ditët e qeta.



PESHORJA
Mendoni se sot jeni zgjuar pa asnjë interes dhe disi të plogësht. Me fillimin e ditës do të shikoni që gjithçka do të ndryshojë.



AKREPI
Sot ndiheni vetëm dhe kjo gjë po ju rëndon psikologjikisht. Do të donit të kishit pranë një mik të mirë, por dhe më të i keni ndërprerë marrëdhëniet.



SHIGJETARI
Një zhvillim i papritur sot premtion ndryshime radikale në jetën tuaj. Duhet të merrni vendime që kanë të bëjnë me të ardhmen tuaj.



BRICJAPI
Të gjithë vëmendjen tuaj sot do ta marrë mbrëmja. Po përgatiteni për një festë mes miqsh ku sigurisht do të jeni protagonist.



UJORI
Sot, për siguri, po qëndroni larg ndjenjave. Ka një person që po ndikon tek ju në çdo moment të ditës, por ende nuk po e pranoni.




PESHQIT
Disa ndryshime të fundit mund ta bëjnë ditën tuaj më interesante. Gjërat që do të vijojnë do të jenë pasojë e ndryshimeve.

Khaketa e Michael Jacksonit del në ankand



Xhaketa e zezë prej lëkure e Michael Jacksonit, që e mbajtjti veshur në turneun e tij të parë solo, do të dalë në ankand në nëntor. Vlera e saj mund të shkojë deri në 100 000 dollarë. Shtëpia e ankandit Julien ka njoftuar se i ndjeri e veshi xhaketën në shpinën e së cilës gjendet nënshkrimi i tij i

përhershëm prej argjendi, nëpër koncerte të ndryshme përgjatë viteve 1987 deri më 1989. Xhaketa, me zinxhirë të shumtë e kopsa, është një nga më të njohurat e këngëtarit, së bashku me xhaketën kuq e zi të "Thriller" që u shit në ankand për 1.8 milion dollarë në vitin 2011.



Adele, më e pasura mes të rinjve britanikë nën 30 vjeç

Me gati 170 milionë euro, Adele ka fituar edhe për vitin 2018 titullin e 'yllit' më të pasur nën 30 vjeç në Mbretërinë e Bashkuar. Këngëtarja e "Hello" mban pozicionin e saj në

krye të renditjes së hartuar nga revista "Heat" për të tretin vit radhazi. Nga ana tjetër, Ed Sheeran dhe Daniel Radcliffe janë renditur respektivisht në vend të dytë dhe të tretë.

Ariana Grande performon për herë të parë që nga vdekja e Mac Millerit



Ariana Grande ka bërë rikthimin e saj triumfues në skenë. Mbrëmjen e së hënës në NBC u transmetua "A Very Wicked Halloween: Celebrating 15 Years on Broadway". Dhe këngëtarja bëri një interpretim mbresëlënës të "The Wizard and

I". Performanca solli për herë të parë në skenë Granden që nga vdekja e ish të dashurit të saj, Mac Miller, në shtator dhe ndarja me ish të fejuarin Pete Davidson, në mes të tetorit. Që pas vdekjes së Millerit, ajo anuloi një sërë performancash.

Ndahen Kourtney Kardashian dhe Luka Sabbat



Kourtney Kardashian dhe Luka Sabbat janë ndarë pas një lidhje disamujore. "Kourtney nuk po takohet më me Lukan. Ishte një lidhje e shkurtër simpatike për të, por jo ndonjë gjë e madhe", ka thënë një burim për revistën

"People". Por Kardashian nuk është zemërthyer pas kësaj ndarje. "Ajo ka gjëra shumë më të rëndësishme për t'u fokusuar, si fëmijët e saj dhe puna. Kourtney po ia del mbanë shumë mirë. Ajo mezi po i pret pushimet", ka thënë ky burim.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

CHELSEA - DERBY

4+

WEST HAM - TOTTENHAM

GG3+

ABERDEEN - HAMILTON

1

Bregu: Ditë të mira e presin gjimnastikën e Kosovës

Trajnerja shqiptare Abeliana Bregu është optimiste se sporti i gjimnastikës së Kosovës ka një të ardhme të ndritur ndërkombëtare. "Për një gjë jam e sigurt, se ditë të mira e presin sportin e gjimnastikës, pasi nuk mungojnë talentet dhe dëshira për të punuar", ka thënë Bregu në këtë intervistë për "Epokën e re". Ajo ka folur edhe për aktivitetet e suksesshme ndërkombëtare me Klubin e "Elitës", kurse e ka vlerësuar pozitive paraqitjen e Vilëza Zeqirit, Valëza Ramës, Amela Gërbeshit dhe Bora Hotit në Slloveni



aktivitetin e Italisë, ka pasur dallim dhe shumë ndryshime si për nga cilësia por, përveç disiplinës, trau i ekuilibrit që në Kosovë e ushtrojmë në traun e ekuilibrit që është 20 centimetra, kurse në garat jashtë shtetit është 1.25 centimetra dhe kjo fëmijën e ngarkon shumë nga ana psikologjike. Në disiplinat e tjera ka qenë paraqitje e mirë nga të katër vajzat.

"Epoka e re": Po sa kohë duhet Kosova të presë që ky sport t'i sjellë medalje ndërkombëtare?

Bregu: Jemi në rrugë të duhur, por për të marrë pjesë në aktivitetet jashtë shtetit duhet që të kesh minimum pesë apo gjashtë vjet stërvitje. Ndoshta kemi filluar pak herët, por është më mirë që jemi duke i mësuar fëmijët me gara jashtë vendit. Ne do të punojmë dhe shpresat nuk i humbim asnjëherë që në të ardhmen të sjellim medalje.

"Epoka e re": Pas pjesëmarrjes në dy garat ndërkombëtare, a keni marrë ndonjë lëvdatë apo këshillë nga institucionet përkatëse shtetërore të sportit?

Bregu: Gjimnastika është një sport i ri dhe normalisht se ka nevojë për përkrahje, por realisht askush nuk na ka pritur e as vizituar. Nuk kemi marrë asnjë urim që kemi qenë pjesëmarrës jashtë vendit. Kjo nuk më pëlqen, por personat kompetentë e dinë më mirë se si të veprojë.

"Epoka e re": Pjesëmarrje në garën e Italisë, të Maqedonisë, pastaj në Slloveni. Cila do të jetë gara e radhës për gjimnastet e 'Elitës' dhe Kosovës?

Bregu: Kur jemi kthyer nga Sllovenia na ka ardhur një ftesë tjetër nga Federata e Ukrainës për një aktivitet që mbahet në pranverë. Është një aktivitet shumë i fortë dhe ne ende nuk e dimë se a mund të shkojmë apo jo.

"Epoka e re": Sipas jush, çfarë duhet të bëjë Ministria e Sportit më shumë për gjimnastikën?

Bregu: Ministria duhet të investojë më shumë në salla, por edhe te sportistët në trajnime të ndryshme. Ministria e Sportit e di më se miri se çfarë i duhet një sportisti për të ecur përpara.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 30 TETOR - Abeliana Bregu është një nga sportistët më të suksesshme në sportin e Shqipërisë, kurse tash me sukses është duke e kryer punën e trajneres së gjimnastikës në Kosovë. Abeliana me përvojën e madhe në garat ndërkombëtare është duke i edukuar sportistët e reja në kryeqytetin e Kosovës për të ecur sigurt rrugës që dikur kishte ecur edhe vetë ajo. Të martën në

"Epoka e re": Abeliana, jeni që disa vjet pjesë e sportit të gjimnastikës në Kosovë. Mund të na tregoni më hollësisht se si ishte atëherë gjendja në këtë sport dhe si është tash?

Bregu: Sportin e gjimnastikës në Kosovës e kam gjetur jo të zhvilluar. Kam qenë pjesë e gjimnastikës së Kosovës në aktivitetin e dytë që kanë mbajtur, nëse nuk gaboj në vitin 2012, dhe nëse e bëjmë një krahasim me të tanishmen, mund të vërehet një dallim i madh. Sigurisht se edhe

Mirëpo me punë kemi arritur ta ngrehim edhe numrin e fëmijëve dhe lirisht mund të them se kemi talente që mund ta çojnë gjimnastikën e Kosovës përpara. Klubi i "Elitës" ka dy vjet që funksionon dhe ky vit ka qenë më i suksesshëm për faktin se kemi marrë pjesë në dy aktivitete ndërkombëtare. I pari ka qenë në muajin qershor në Itali, pastaj në Maqedoni dhe, së fundmi, në Slloveni. Në Itali e kemi pasur mbështetjen e federatës me 30 %, sipas rregullores që ata e kanë vendosur, pjesa tjetër është realizuar nëpërmjet prindërve të fëmijëve garues. Ndërsa në Slloveni nuk kemi pasur fare mbështetje financiare nga Federata, përveç mbështetjes me dokumente për marrjen e vizave të sportistëve. Gjithçka është realizuar nëpërmjet donacioneve dhe nga prindërit e fëmijëve garues.

"Epoka e re": Gjatë vizitave që kemi pasur në klub kemi parë se garueset e reja ju kanë model. Por gjatë kësaj kohe sa ke punuar me to, a keni vërejtur cilësi të ndonjëra nga gjimnastet se mund të jetë Abeliana Bregu e Kosovës?

Bregu: Besoj se po. Ndihej shumë mirë që fëmijët më marrin model dhe shpresoj se edhe ata të ecin rrugës sime. Lirisht mund të them se kemi talente që në të ardhmen mund të marrin medalje në garat ndërkombëtare, por e gjitha ka të bëjë me orët e punës. Duhet të kemi parasysh se sa orë bën një

sportist përgatitje për t'u përballur me një sport jashtë Kosovës, por pa harruar edhe ambientin stërvitor dhe kushtet e tjera elementare që duhen për përgatitje.

"Epoka e re": Në Kosovë dita-ditës po shtohen klubet e gjimnastikës. A keni pasur kërkesë nga ndonjë klub tjetër që të bartni ndonjë përvojë apo sugjerim rreth formimit dhe organizimit të punës me gjimnastet e rinj?

Bregu: Gjithmonë kam qenë e gatshme t'i ndihmoj edhe klubet e tjera, por nuk më është kërkuar deri tash. Klubet i kanë metodat e veta të punës dhe, ndoshta, metodat e mia mund të mos jenë të përshtatshme për to.

"Epoka e re": Të rikthehemi edhe një herë te gara e fundit ndërkombëtare në Slloveni. Cili është komenti juaj me paraqitjen e katër gjimnastëve?

Bregu: Të them të drejtën, më ka pëlqyer paraqitja e sportistëve në Slloveni. Në krahasim me



intervistë për "Epokën e re", Bregu ka treguar se si e kishte gjetur sportin e gjimnastikës gjashtë vjet më parë, kurse është shprehur e kënaqur me progresin e bërë deri tash në këtë sport. "Sportin e gjimnastikës në Kosovës e kam gjetur jo të zhvilluar. Kam qenë pjesë e gjimnastikës së Kosovës në aktivitetin e dytë që kanë mbajtur, nëse nuk gaboj në vitin 2012, dhe nëse e bëjmë një krahasim me të tanishmen, mund të vërehet një dallim i madh. Sigurisht se edhe numri i klubeve është shtuar dhe cilësia ka filluar të rritet. Jo vetëm klubi ynë, por të gjitha klubet po mundohen ta çojnë përpara sportin e gjimnastikës", ka thënë Bregu.

numri i klubeve është shtuar dhe cilësia ka filluar të rritet. Jo vetëm klubi ynë, por të gjitha klubet po mundohen ta çojnë përpara sportin e gjimnastikës. Federata është munduar të na mbështesë, por edhe ajo ka pasur problemet e veta financiare. Për një gjë jam e sigurt, se ditë të mira e presin sportin e gjimnastikës, pasi nuk mungojnë talentet dhe dëshira për të punuar.

"Epoka e re": Përvojën tuaj ndërkombëtare kemi filluar ta bartni te nxënëset e Klubit "Elita". Për dy vjet funksionim, cilat janë rezultatet nga ky klub?

Bregu: Fillimisht e kemi filluar me dy fëmijë, pra nga zero.

Gashi: Zhuri do të bëhet me stadium të ri dhe modern

PRISHTINË, 30 TETOR - Zhuri do të bëhet me stadium të ri modern që i plotëson nevojat e sportistëve zhurianë. Kështu ka thënë ministri i Sportit, Kujtim Gashi, i cili ka marrë pjesë në vënien e gurthemelit të stadiumit. Ky projekt kapital vjen në kuadër të plotësimin të

infrastrukturës sportive fizike në të cilin Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të investojë 700 mijë euro, ndërkaq Komuna e Prizrenit do të ndajë 200 mijë sosh. Ministri Kujtim Gashi e ka vlerësuar këtë projekt të rëndësishëm së veçantë për

sportistët e Zhurit me rrethinë. Ministri me këtë rast i uroi klubin dhe qytetarët e Zhurit me rrethinë. "Ka qenë ëndërr për sportistët e futbollistët e talentuar për këtë stadium. Është projekt që financohet me një pjesë të madhe nga ministria dhe me një participim nga

Komuna e Prizrenit", ka thënë Gashi, duke shtuar se Zhuri njihet edhe në të kaluarën që ka pasur një klub shumë të suksesshëm. "Besoj se sot Zhurit dhe fshatrave përreth po ia krijojmë një mundësi të re", ka deklaruar ministri Gashi.



Drita i hakmerret Flamurtarit, Liria dhe Ferizaj ndajnë pikët

PRISHTINË, 30 TETOR - Të martën janë zhvilluar dy ndeshjet e para të javës së 13 në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Skuadra kampione në fuqi, Drita, e ka realizuar fitoren e pestë radhazi dhe në këtë mënyrë i është hakmarrë skuadrës së Flamurtarit për humbjen që ia kishte shkaktuar në ndeshjen e zhvilluar në Gjilan. Golin e fitores për skuadrën e Shpëtim Duros e realizoi Endrit Krasniqi në minutën e 25-të pas asistimit të Xhevdet Shabanit. Pas kësaj fitoreje Drita ngjitet në pozitën e katërt në kuotën e 22 pikëve, derisa Flamurtari zbrit në pozitën e pestë më 19 pikë. Në ndeshjen tjetër që u zhvillua në stadiumin "Përparim Thaçi" në Prizren ndërmjet Lirisë dhe Ferizajt, skuadra këto që po përballen me krizë të rezultateve, nuk pati fitues. Ndeshja u mbyll me shifrat 0-0. Prizrenasit patën paraqitje më



të mirë dhe krijuan disa raste shënimi, madje në minutën e 90 e gjetën edhe rrugën e rrjetës, por goli i Fetahajt ishte i pavlefshëm për pozitë jashtëloje.

Sot (e mërkurë) zhvillohen katër ndeshjet e tjera të kësaj jave në elitën e futbollit të Kosovës.

IPKO SUPERLIGA

Flamurtari - Drita 0-1
Liria - Ferizaj 0-0

Të mërkurën takohen:
12:30 Prishtina - Trepça '89
12:30 Feronikeli - Drenica
12:30 Llapi - Ballkani
12:30 Gjilani - KEK-u

Tjetër zhgënjim nga Lakersat

MINNESOTA, 30 TETOR - Tjetër humbje për LA Lakers, që u mposht me rezultat 124-120 nga Minnesota, jashtë fushës, ndeshje me rivalitet dhe emociione deri në fund, moment kur vendësit arritën të shkëputeshin e fitojnë. Butleri me 32 pikë e Townsi me 25 pikë e 16 rebaunde ishin më të mirët në fushë për Minnesotan, ndërsa për Lakersat nuk mjaftuan 29 pikë e 10 rebounde të LeBron Jamesit. Humbjen e parë e pësoi skuadra e Torontos, që u mund 124-109 nga Milwaukee, një përballje mes dy ekipeve surprizë të NBA-së. Takimi u dominua nga lojtarët e Bucksit (7 lojtarë realizuan mbi 10 pikë), që janë skuadra e vetme ende pa asnjë humbje në NBA, ndërsa për kanadezët nuk mjaftuan 30 pikët e Ibaka për ta evituar humbjen.

San Antonio ka fituar derbin me Dallasin, duke triumfuar 113-108 pas kohës shtesë, sfidë me emociione dhe rivalitet. DeRozani me 34 pikë ishte lider në fushë për Spursin, duke i bërë të pavlefshme 31 pikët e



Donqit për miqtë. Triumfon edhe Denveri, që mundi 116-111 New Orleansin, sfidë e dominuar nga vendësit, me Harrisin e Murrayn që realizuan nga 23 pikë secili.

REZULTATET

Indiana - Portland	93-103
Philadelphia - Atlanta	113-92
Miami - Sacramento	113-123
New York - Brooklyn	115-96
Chicago - Golden State	124-149
Milwaukee - Toronto	124-109
Minnesota - Lakers	124-120
San Antonio - Dallas	113-108
Denver - New Orleans	116-111

SHKURT

Organizohet turneu i gjashtë përkujtimor i shahut "Mustafë Ibrahimimi"

Për ta përkujtuar dhe nderuar figurën e patriotit dhe veprimtarit për çështjen kombëtare, anëtarit të Klubit të Shahut Mustafë Ibrahimimi, Klubi i Shahut NLB Prishtina organizon turneun e gjashtë, tani tradicional përkujtimor "Mustafë Ibrahimimi". Ky turne do të mbahet më datë 30 tetor 2018 në sallën e shahut në QRS në Prishtinë, duke filluar nga ora 17.00. Garat do të zhvillohen sipas sistemit (13 xhiro, 3min+2sec sipas rregullave të FIDE). Për më të mirët: kupa, medalje, premi, diploma e shpërblime dhe mirënjohje për të gjithë pjesëmarrësit. Është paralajmëruar pjesëmarrje e madhe e shahistëve më të mirë të vendit dhe jashtë Kosovës.

Dele Alli vazhdon kontratën me Tottenhamin

Mesfushori anglez i Tottenhamit, Dele Alli, ka nënshkruar kontratë të re me klubin që do ta mbajë atë në Londër deri më 2024. 22-vjeçari iu bashkua londinezëve për pesë milionë euro më 2015 dhe deri tash ka shënuar 48 gola në 153 paraqitje. Sivjet është paraqitur gjashtë herë në Premierë Ligë, por s'ka shënuar gol që nga ndeshja e parë.

Inzaghi kritikon Strakoshën

Humbja kundër Interit e ka zhveshur nga alibitë trajnerin e Lazios, Simone Inzaghi, i cili vlerësoi kundërshtarin, por nuk u kursye në kritikën ndaj ekipit të tij. Në veçanti, Inzaghi pati në shënjestër portierin e kombëtares shqiptare të futbollit, Tomas Strakosha, edhe pse ky i fundit në 3 gola e pësuar pati pak ose thajse aspak faj. "Në këto ndeshje nuk mund t'i lejojmë vetes që të pësojmë gola si ai i pari që shënoi Interi. Nuk kujtoj dot asnjë pritje të Strakoshës në këtë ndeshje, por kujtoj shumë nga Handanoviçi. Interi gjithsesi e meritoi fitoren dhe nuk duhet të kërkojmë justifikime", ka thënë Inzaghi.

Barça në janar e shet Dembelen

